



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 4781 Prot.

Tiranë, më 19.07.2014

URDHËR

Nr. 307, datë 14.07.2014

PËR
STRUKTURËN E VITIT SHKOLLOR 2014 - 2015 NË SISTEMIN ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe germës "ç" të pikës 2 të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

- I. Struktura e vitit shkollor 2014 - 2015 të jetë si më poshtë:
 1. Në arsimin bazë
 - a. Mësim
Viti shkollor fillon më 15 shtator 2014 dhe mbaron më 5 qershor 2015.
 - b. Pushime
Periudha e parë fillon më 24 dhjetor 2014 dhe mbaron më 4 janar 2015.
Periudha e dytë fillon më 26 mars 2015 dhe mbaron më 31 mars 2015.
 - c. Provime
Provimet e Lirimit zhvillohen në periudhën 6 - 30 qershor 2015.
 2. Në arsimin e mesëm të lartë
 - a. Mësim
Viti shkollor fillon më 15 shtator 2014 dhe mbaron më 5 qershor 2015.
Për maturat, viti shkollor fillon më 15 shtator 2014 dhe mbaron më 22 maj 2015.
 - b. Pushime
Fillojnë më 24 dhjetor 2014 dhe mbarojnë më 4 janar 2015.
 - c. Provime
Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 23 maj - 30 qershor 2015.
- II. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri: Drejtoria e Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, DAR/ZA-të dhe të gjitha institucionet e sistemit arsimor parauniversitar.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

